

31.01.2022

Ora 18:13

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për përcaktimin e kushteve dhe kritereve që duhet të plotësojë personeli i kualifikuar për përdorimin e pajisjes së identifikimit elektronik të votuesve në qendrën e votimit dhe të procedurave të rekrutimit”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

• **Komisioni Rregullator:**

- **Ilirjana NANO Kryetar**
- **Arens ÇELA Anëtar**
- **Dritan ÇAKA Anëtar**
- **Helga VUKAJ Anëtar**
- **Muharrem ÇAKAJ Anëtar**
- **Stafi KQZ Y. Merkaj, M. Koja**
- **Parti Politike: LSI (A. Kaziaj)**

OJQ: KRIK

Znj. I. Nano: Mirëmbërëma të gjithëve. Sot në rendin e ditës kemi shqyrtimin e një projektvendimi “Për përcaktimin e kushteve dhe kritereve që duhet të plotësojë personeli i kualifikuar për përdorimin e pajisjes së identifikimit elektronik të votuesve në qendrën e votimit”. Para se t’u jap fjalën përfaqësuesve të administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, do të doja të theksoja që një akt të ngjashëm kemi miratuar edhe për zgjedhjet për Kuvend, të datës 25 Prill 2021 duke u konsideruar një risi teknologjike. Kjo rezultoi e suksesshme pra, përdorimi i pajisjeve të identifikimit elektronik dhe procesi i caktimit të një personeli të kualifikuar për përdorimin e këtyre pajisjeve. Në mbledhje janë të pranishëm të gjithë anëtarët e Komisionit

Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.31.01.2022*

Rregullator, përfaqësues të partive politike, Sekretari i Përgjithshëm i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe zyrtarë të tjerë të administratës të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Ky projektvendim vjen në Komisionin Rregullator me propozim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe Nënkomisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Do të kërkoja nga ana e administratës prezantimin e projektaktit. Çfarë risie sjell në raport me vendimin e mëhershëm për zgjedhjet e 25 prillit? Zoti Merkaj!

Z. Y. Merkaj: Me vendimin numër 10, datë 29.01.2022, Komisioni Rregullator ka vendosur që në zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 6 Mars 2022, identifikimi i votuesve të realizohet nëpërmjet pajisjeve të identifikimit elektronik PEI, të cilat u përdorën në zgjedhjet e përgjithshme për Kuvend, të datës 25 Prill 2021. Referuar përcaktimit të nenit 14, 19, 20 dhe 23 të Kodit Zgjedhor, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve dhe Nënkomisioneri kanë paraqitur projektvendimin e mësipërm, si kompetencë e Komisionit Rregullator. Qëllimi i këtij vendimi është përcaktimi i rregullave të pranimit dhe trajnimit të personeli, që do të caktohet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve si operator teknik për përdorimin e pajisjeve të teknologjisë së informacionit për identifikimin elektronik të zgjedhësve në qendrat e votimit. Objekti i këtij vendimi është të përcaktojë kushtet dhe kriteret që duhet të plotësojnë shtetasit shqiptarë, që të caktohen si operatorë teknikë për përdorimin e pajisjes së identifikimit elektronik të zgjedhësve PEI, procedurat e përzgjedhësve të caktimit të operatorit teknik dhe përgjegjësitë e operatorit teknik gjatë ofrimit të shërbimit. Pranimi i operatorit teknik do të bëhet në bazë të parimit të konkurrimit të hapur. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, jo më vonë se 24 orë nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të Komisionit Rregullator, shpall publikisht thirrjen për shprehje interesi nga shtetasit që janë të gatshëm të ofrojnë shërbim si operatorë teknikë për përdorimin e pajisjes PEI. Aplikimi nga të interesuarit

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.31.01.2022*

bëhet në faqen zyrtare të KQZ-së në një rubrikë të veçantë, të krijuar për këtë qëllim. Jo më vonë se 15 ditë para datës së zgjedhjeve, strukturat përgjegjëse të administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, përgatisin listën e shtetasve, të cilët përbushin kërkesat dhe kushtet për të qenë operatorë teknikë. Shtetasit e përzgjedhur i nënshtrohen trajnimit dhe testimit të njohurive për shërbimin si operatorë teknikë. Ky proces mbikëqyret dhe monitorohet nga Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Ofrimi i shërbimit bëhet në përputhje me kontratën e nënshkruar nëpërmjet Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe operatorëve. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, si dhe dokumentacionin përkatës, faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit, zoti Merkaj! Fillojmë me shqyrtimin e projektvendimit. Ndërkohë për procedurë, më duhet të pyes kolegët, anëtarët e Komisionit Rregullator, apo përfaqësuesit e partive politike, nëse kanë ndonjë çështje jashtë rendit të ditës për të diskutuar sot. Nuk ka! Atëherë fillojmë me shqyrtimin në parim të projektvendimit, kush dëshiron fjalën lidhur me projektvendimin në parim ka diçka, zoti Kaziaj, kolegë? Po zonja Vukaj!

Znj. H. Vukaj: Thjesht mund të shtojmë për publikun një parantezë dhe mund të themi që ky është një akt që e ka dhënë përvojën e tij në thelb. Vjen ashtu siç ju e përmendët dhe kërkuat krahasimin tek administrata mes këtij drafti dhe atij të mëparshmit, vjen pas një analize të çfarë duhet të bëjmë më mirë, pra çfarë duhet të përmirësohet në këto zgjedhje në raport me ato që u zhvilluan. Kështu që dakordësia në parim vjen si pasojë e reflektimit të një dakordësie të mëparshme, më pas nen për nen kur të shqyrtohet do të shprehim opinionet tona.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.31.01.2022*

Znj. I. Nano: Në rregull, faleminderit! Atëherë, kolegë kalojmë në votimin në parim të projektvendimit, “Për përcaktimin e kushteve dhe kriterëve që duhet të plotësojë personeli i kualifikuar për përdorimin e pajisjes së identifikimit elektronik të votuesve në qendrën e votimit dhe të procedurave të rekrutimit”.

Kush është dakord, në parim?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S’ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Kalojmë në diskutimin, në shqyrtimin e projektaktit nen për nen. Sikundër tashmë kemi vendosur një standard në rastet e akteve voluminoze dhe nisur dhe nga fakti që projekti është shpërndarë më herët, është publikuar në faqen zyrtare të KQZ-së, u është shpërndarë partive politike, nuk do t’i lexojmë një nga një nenet, gjithë përmbajtjen e neneve.

Kështu që fillojmë me nenin 1. Qëllimi dhe objekti, të cilat u prezantuan edhe më herët nga Sekretari i Përgjithshëm. Pra, rregullat për pranimin, trajnimin e personelit, kushtet, kriteret, procedurat e përzgjedhjes dhe përgjegjësitë e operatorit teknik gjatë ofrimit të shërbimit. Kolegë, përfaqësues të partive politike, nëse kanë diçka lidhur me nenin 1, me përmbajtjen e tij? Nuk kemi diskutime! Atëherë kalojmë në votimin e nenit 1. Qëllimi dhe objekti.

Kush është dakord?


Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S’ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Neni 2. Papajtueshëritë me detyrën e operatorit teknik. Në këtë projektvendim janë caktuar rastet ku nuk mund të caktohet si operator teknik një shtetas që ka marrëdhënie krushqie apo gjinie deri në shkallë të katërt. Marrëdhënie pune me kandidatët që konkurrojnë në zonën zgjedhore, ose dhe kjo është shumë e rëndësishme, nëse është ushtarak, punonjës i strukturave të Policisë së Shtetit,

*Zbardhi materialin audio
Merița DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.31.01.2022*

Gardës së Republikës, Ministrisë së Brendshme, Shërbimit Informativ Shtetëror dhe agjencive të tjera të inteligjencës, qoftë në Ministrinë e Mbrojtjes, apo Ministrinë e Punëve të Brendshme. Kemi diçka lidhur me këtë nen, me papajtueshmëritë, mendoni se mund të shtojmë apo të heqim diçka? Apo i prezantuar në këtë mënyrë përmbush kërkesat për papajtueshmëritë në raport me detyrën e operatorit teknik. Zoti Kaziaj!

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Tek neni 2, pika e parë, “b” tek pjesa e togfjalëshit të fundit, që thotë “dhe shërbime të tjera, me objekt veprimtarie të ngjashme me sa më sipër”. Çfarë është nënkuptuar?

Znj. I. Nano: Po! Zoti Merkaj, zonja Koja? Kur flasim për “shërbime të tjera me objekt veprimtarie të ngjashme me sa më sipër”, në shkronjën “b”?

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Saktësoj faktin se në shkronjën “b” siç thatë ju Kryetare, është e mirëcilësuar të themi, pjesa e detyrave shtetërore, të cilat nuk mund të marrin pjesë në përzgjedhjen e këtyre operatorëve, të themi. Por, thjesht togfjalëshi që thashë, lë pak për interpretim dhe nuk e di se cili ka qenë qëllimi në vetvete.

Znj. I. Nano: Mesa unë kuptoj, por gjithsesi administrata mundet të na japë një vlerësim, lidhet me çdo lloj shërbimi inteligjence, pra që kryen të njëjtën veprimtari si ato të cituara më sipër.

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Shërbimet jopartnere? Cilat janë shërbimet, se ne këto shërbime kemi në Shqipëri. Cilat janë shërbimet?

Znj. I. Nano: Në fakt flasim për shtetas shqiptarë.

*Zbardhi materialin audio
Merița DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.31.01.2022*

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Po, pikërisht, shërbime inteligjence shqiptare është ai i ushtrisë dhe Shërbimi Informativ Shtetëror, të paktën në dijeninë time.

Znj. I. Nano: Atëherë, zoti Kaziaj, ju e kishit pyetje apo keni propozim për heqjen, për të vendosur një pikë në përfundim të fjalës së ankesave dhe për heqjen? Kjo ndoshta ka dashur, projektvendimi të jetë më gjithëpërfshirës, për të mos i nominuar të gjithë shërbimet me radhë. Po, zonja Vukaj!


Znj. H. Vukaj: Me sa kujtoj vjet, sepse ky draft buron nga përmbajtja, pothuajse nga përmbajtja e aktit që është miratuar për zgjedhjet e 2021-shit. Kemi pasur ndoshta merakun se mos ndonjë strukturë apo agjenci tjetër ligjzbatuese na ka shkarë, apo është anashkaluar dhe për këtë arsye kemi vendosur këtë shprehjen përgjithësuëse, mesa kujtoj, në draftim. Në qoftë se pastaj drejtoria juridike ka ndonjë memorie tjetër se çfarë përfshin? Se vërtetë këtu themi, është ushtarak. Pra, shtetasi i cili është ushtarak, pra e kufizojmë, por nuk kemi përmendur shërbimin, i cili atashohet, shërbimin inteligjent që atashohet pranë Ministrisë së Mbrojtjes.

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Është i përmendur, agjencia e inteligjencës dhe e sigurisë së mbrojtjes.

Znj. I. Nano: Atëherë, zoti Kaziaj edhe njëherë, e keni pyetje dhe kërkoni sqarim apo keni propozim?

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Do më falni zonja Nano, por do i kthej përgjigje zonjës Vukaj, në qoftë se s'gaboje ky është vendimi nr. 7 që ka marrë

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.31.01.2022*

po ky komision në vitin 2021. Le të themi i futur në frymën e zgjedhjeve të pjesshme vendore në këtë rast, duke shfuqizuar ose duke lënë atë vendim të tillë që kishte efekte vetëm për ato zgjedhje. Fakti është që unë e kisha pyetje apo jo, zonja Nano është, më shumë ju sjell juve në vëmendje një gjë të tillë që, cilët janë personat që s'mund të aplikojnë për këtë. Jeni ju Komisioni që vendosni, pavarësisht se nuk kam një propozim konkret për këtë.


Znj. I. Nano: Në varësi të aplikimit të kandidatëve për operatorë, ku paraqitet dhe CV-ja e tyre, atëherë do të shihet nëse ka papajtueshmëri ose jo. Zoti Çakaj!

Z. M. Çakaj: Faleminderit, zonja Nano! Kisha dhe unë një merak në fakt që në rastin konkret, papajtueshmëritë me detyrën e operatorit teknik, në pikën a, kemi parashikuar, marrëdhëniet e krushqisë së afërt, apo të gjinisë deri në shkallë të katërt, ose marrëdhënie pune me ndonjërin nga kandidatët që konkurrojnë. Në gjykimin tim një situatë papajtueshmërie, mund të ishte dhe marrëdhënie pune me kompaninë, e cila ka ofruar ose nënkontraktore. Pra, një kompani që është nënkontraktore me kompaninë, e cila ka ofruar këto pajisjet elektronike të identifikimit. Pra, në gjykimin tim është.., ndodhemi përballë një situatë konflikti interesi në rastin konkret dhe kjo kategori punonjësish, në gjykimin tim, sado e vogël të jetë numri, duhet të jetë e përjashtuar nga detyra e operatorit. Pasi është në marrëdhënie pune me kompaninë, e cila ka ofruar këto. Mund të jemi hipotetikisht në një situatë konflikti interesi. Kështu që propozojmë që ta shtojmë këtu, në pikën "a".

Znj. I. Nano: Unë mendoj që bëhet fjalë për një kompani të huaj në rastin konkret.

Z. M. Çakaj: Po, por stafi implementues ka qenë vendas.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.31.01.2022*

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Jam dakord, në qoftë se mundem, me zotin Çakaj, është një cilësim shumë interesant kjo që bëri anëtari i Rregullatorit, përse i përket pjesës së faktit që këto pajisje janë prokuruar dhe kemi të bëjmë me personel shqiptarë, i cili ka punuar mbi to. Në qoftë se s'duam ta paragjykojmë procesin apriori që në nisje, më mirë është që kjo të vihet në mënyrë ekskluzive të këtyre personave.

Z. M. Çakaj: Do doja dhe një opinion nga drejtoria juridike për këtë propozim, apo Sekretari i Përgjithshëm?

Z. Y. Merkaç: Unë mendoj që është një personel shumë i vogël, megjithatë mund ta përjashtojmë. Personeli shqiptar është shumë i vogël si numër. Mund të jetë diku tek 30 veta.

Z. M. Çakaj: Mjaftueshëm për t'u identifikuar si persona në konfliktin e interesit, në gjykimin tim kjo.

Znj. I. Nano: Jo, në kuptim të ligjit, konflikt të interesave është një konflikt mes detyrës publike dhe interesave privatë. Në këtë rast detyra publike do të ishte detyra e operatorit. Kush do të ishte interesi privat?

Z. M. Çakaj: Detyra publike është detyra e operatorit, i cili në rastin konkret do të marrë atributin e nëpunësit zgjedhor pra, krijon një funksion publik. Interesi privat i tij është që ka qenë nënkontraktor, ose në cilësinë e të punësuarit të kompanisë, e cila ka implementuar projektin.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.31.01.2022*

Znj. I. Nano: Si e favorizon interesin privat, në këtë rast, nëpërmjet detyrës publike? Pra, në qoftë se kryen detyrën e një operatori.

Z. M. Çakaj: Në situatën më të keqe të mundshme, duke manipuluar të dhënat, që është e nevojshme të shprehim këtë? Kur ndërkohë ne mund ta përjashtojmë këtë situatë.

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Ajo është shumë e qartë. Unë jam shumë dakord. Fakti është që këta persona mund të manipulohen.

Znj. I. Nano: Ja një moment se nuk ju kam dhënë fjalën zoti Kaziaj!

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Kërkoj fjalën, faleminderit!

Znj. I. Nano: Po, ja një moment! Është parashikuar në këtë projektvendim, në nenin 8, në pikën 7, detyrat operacionale të cilat do të vendosen me një akt të përbashkët të Komisionerit dhe Nënkomisioneres. Gjithashtu tek përgjegjësitë e operatorëve teknikë, sigurisht që kemi parashikuar qoftë përgjegjësitë civile, në rast të veprimeve apo mosveprimeve në kundërshti me kontratën, por edhe përgjegjësi penale në rast se shkelet legjislacioni penal në fuqi. KQZ-ja, të paktën nga zgjedhjet e kaluara dhe pas verifikimit paszgjedhor nuk është druajtur që të bëjë kallëzim penal për zyrtarë të administratës zgjedhore që kanë shkelur ligjin. Pra, roli i operatorit të PEI-it, unë nuk besoj se ka lidhje me manipulimin ose jo të të dhënave. Megjithatë, në qoftë se e gjykoni, e formulojmë në formën e një propozimi dhe e votojmë. Zonja Vukaj!

Znj. H. Vukaj: Në këtë arsyetim që ndoqet zonja Nano, do të thosha që, vërtet nuk do të ngurronte KQZ-ja që ta çonte para përgjegjësisë penale një person, i

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.31.01.2022*

cili do të kishte atë për qëllim, por ideja është që deri sa të kryhet ky proces, ndikimi ka ardhur, pra pasoja është dhënë. Prandaj më duket me vend propozimi i zotit Çakaj.

Znj. I. Nano: Atëherë mund ta formuloni zoti Çakaj propozimin dhe pastaj t'i jap fjalën dhe zotit Kaziaj.

Znj. H. Vukaj: Edhe diçka tjetër administratës, tek draftimi, shoh tek pika e parë, ku themi “shtetasi i cili ka marrëdhënie krushqie të afërt ose gjinie deri në shkallë të katërt”. Pra, këtu e kemi bërë shkallën e shpërndarjes dhe merakut për ta kufizuar deri në shkallë të katërt. “Ose marrëdhënie pune me ndonjërin nga kandidatët”. Lind pyetja, po me personat më të afërt të kandidatit, që janë bashkëshorti, bashkëshortja, biri, bija, a do të kishte impakt? Sigurisht që po! Përsa kohë ligji për konfliktin e interesit i rendit në germat e para këtë kategori personash, mendoj që duhet implementuar, për shkak se japin impakt.

Znj. I. Nano: Nëse më lejon zonja Vukaj, një propozim, përveç asaj që zoti Çakaj e kishte si propozim konkret, në rastin e konfliktit të interesave, unë do ta gjykoja kështu. Neni 2 thotë, “papajtueshmëritë”, që do të thotë papajtueshmëria nënkupton mosqasjen në asnjë rast të një personi me këtë detyrë. Ndërsa te kushtet për t'u caktuar operator mendoj që mund të shtojmë një dispozitë, “të mos jetë në kushtet e konfliktit të interesave” dhe këtu pastaj gjykohet rast pas rasti konflikti i interesave.

Z. M. Çakaj: Dakord! Domethënë edhe propozimi im konkret konsiston në faktin që në pikën “a”, pas fjalës së fundit, “operatori teknik është caktuar”, të shtohet dhe një fjali tjetër posaçërisht për të pasqyruar këtë situatë. Pra këtu të shtojmë, jo pikëpresje, por të shtojmë presje, “si dhe...

*Zbardhi materialin audio
Merjeta DULAKU*



Znj. I. Nano: Ose marrëdhënie pune...

Z. M. Çakaj: Jo, “si dhe nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit”, kaq. Pastaj e definojmë po ne, e definon po Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve apo Komisioneri, i cili ka tagrin për të emëruar këta, në bazë të Kodit Zgjedhor. Pra, “si dhe nuk ndodhet”. Fjalja, e cila propozoj unë është si vijon pika “a”, pra, “ka marrëdhënie krushqie të afërt ose gjinie deri në shkallë të katërt, ose marrëdhënie pune me ndonjërin nga kandidatët që konkurrojnë zonën zgjedhore ku ndodhet qendra e votimit në të cilën operatori teknik është caktuar, si dhe ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit”. Pra fjalia “nuk mund të caktohet si operator teknik personi i cili ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit” në rastin konkret. Domethënë, si teknikë legislative mua më rri këtu kjo.

Znj. I. Nano: Personalisht unë jam dakord me këtë dispozitë, por e mendoj në një nen tjetër, jo te papajtuësëria. Pra, papajtuësëria dhe situata e konfliktit të interesit nuk janë e njëjta gjë, vetëm këtë merak kam. Po ku ta vendosim? Por që të mos jetë në kushtet e konfliktit të interesave, absolutisht që është një detyrim i KQZ-së në këtë rast që ta identifikojë në momentin e aplikimit të çdo kandidati për operator.

Z. M. Çakaj: Atëherë në rastin konkret mua më rri më shumë në papajtuësëritë me detyrën e operatorit ekonomik. Si ta gjykojnë dhe kolegët. Pra, nuk është se i bëjmë një parashikim konkret, i bëjmë një parashikim të përgjithshëm, nuk ndodhemi në kushtet e konfliktit të interesit.

Znj. I. Nano: Zoti Kaziaj, ju ndërpreva fjalën më herët.

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.31.01.2022*

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Faleminderit zonja Nano! Siç e thashë dhe në pjesën e parë të fjalës time, ky është një vendim i cili është ndërmarrë në përmbajtjen e tij nga ana juaj në vitin e shkuar. Mundësisht të shohim përmirësime të atij vendimi, se çfarë duhet t'i bëjmë dhe në qoftë se administrata na mundëson një kopje të tij, është vendimi nr. 7 i 2021, në qoftë nuk gaboj. Më mundësoni një kopje në mënyrë që, meqë vitin e shkuar, në zgjedhjet për Kuvendin, ishte një risi kjo, teknologjia në zgjedhje, të mundemi të përmirësojmë sado pak, të themi atë që është procesi në vetvete që ndihmon vetë risinë e futur nga ligjvënësi në 2021. Duke ndihmuar në këtë mënyrë dhe vetë operatorët teknikë, të cilët do të procedojnë në datën e zgjedhjeve si operatorë të këtij sistemi, faleminderit!

Znj. I. Nano: Ndërpresim 10 minuta mbledhjen, sapo t'i mundësohet zotit Kaziaj vendimi që kërkoi.


Rifillon mbledhja

Ora 18:50

Znj. I. Nano: Rikthehemi në mbledhjen e Komisionit Rregullator. E ndërpreme pas një kërkesë të përfaqësuesit të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim që kërkoi një akt të mëhershëm të Komisionit Rregullator. Jemi tek neni 2. "Papajtueshmëritë me detyrën e operatorit teknik". Kishim disa diskutime. Ftoj kolegët nëse do t'i përkthejnë në propozime konkrete apo sipas diskutimit do t'i lemë për nenet e tjera.

Z. M. Çakaj: Po, faleminderit zonja Nano! Atëherë, pasi ripamë draftin, ripamë dhe vendimin e parë të miratuar nga Komisioni Rregullator, propozimi konkret

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.31.01.2022*

do të jetë një nen më poshtë. Pra, në nenin 3, lidhur me situatën e konfliktit të interesit. Më konkretisht në nenin, “kushtet për t’u caktuar operatori teknik”.

Znj. I. Nano: Faleminderit! Zoti Kaziaj, ju për nenin 2, keni diçka tjetër apo të kalojmë në votim?

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Jo, unë s’kam asgjë përveç asaj që thashë. Pjesës që duhet të marrim parasysh për të specifikuar dhe mirëspecifikuar në ndryshim nga vendimi nr. 7, i 2021-shit, po i juaji, i Komisionit Rregullator, se çfarë nuk kumtojmë me këtë togfjalësh, të themi dhe për faktin se nuk kam pasur kohën objektive, me sinqeritet e them këtë. Duke qenë se më është komunikuar vetëm në orën 16 të ditës së sotme, kjo vendimmarrje që po shqyrtohet nga ana juaj. Duke qenë se isha në një mbledhje pune, kështu që propozimet me shkrim nuk kam pasur mundësi, po jua sjell thjesht në vëmendje. Komisioni le të vendosë lidhur me...

Znj. I. Nano: Në rregull! Propozim konkret për shtesë/ndryshim në këtë nen, keni?

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Për mua edhe mund të hiqet, nuk ka kuptim ky togfjalësh.

Znj. I. Nano: Pra, propozimi konkret i juaji është?

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Propozimi konkret është, deri tek pika “b” e nenit 2, të pikës 1, deri tek pjesa që thotë “shërbimi i çështjeve të brendshme dhe ankesave”.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.31.01.2022*

Znj. I. Nano: Në rregull! Faleminderit! Atëherë administrata ka diçka për të shtuar? Jo! Kalojmë në votimin e nenit 2, së pari votojmë propozimin e zotit Kaziaj, për heqjen e fjalëve “dhe shërbimeve të tjera me objekt veprimtarie të ngjashme me sa më sipër”.

Kush është dakord, kolegë?

Pro: S’ka

Kundra: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Nuk miratohet propozimi i zotit Kaziaj!

Në fakt ne e diskutuam, është një parashikim gjeneralist, duke mos e kufizuar vetëm në institucione të nominuara me emër.

Atëherë votojmë nenin 2, sipas propozimit të Komisionerit.

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)


Kundra: S’ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Neni 3. Kushtet për t’u caktuar operator teknik.

Sigurisht që janë disa kushte me karakter ligjor, minimalisht duhet patur e drejta për të qenë zgjedhës, të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerje me dashje të një vepre penale, të paktën arsimit të mesëm. Edhe siç do ta shohim në nenin pasardhës përparësia në zgjedhje, kemi dhe operatorë që mund të jenë me arsim të lartë, por dhe me arsim të mesëm. Nuk ka qenë anëtar i komisioneve zgjedhore, grupeve të numërimit në dy zgjedhjet e fundit. Nuk është anëtar i strukturave drejtuese të ndonjë partie politike. Të mos jetë përfshirë në veprimtari politike dhe elektorale 5 vitet e fundit. Aftësi, njohuri minimale të pajisjeve të teknologjisë së informacionit. I gatshëm për të ofruar shërbimin edhe larg vendbanimit. Ka mbetur një diskutim nga pak më parë, zoti Çakaj, dëshironte të shtonte dhe një pikë.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



Z. M. Çakaj: Po zonja Nano, unë propozova! Pra, në kushtet për t'u caktuar operatorët të shtohet dhe pika që "nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit". Kjo është një dispozitë gjeneraliste, e cila do të verifikohet rast pas rasti nga organi përkatës, i cili ka të drejtë të emërojë operatorët teknikë.

Znj. I. Nano: Zoti Çakaj, ku mendoni? Pas pikës "dh", ku përmenden, nuk duhet të jetë, të themi dhe "të mos ndodhet në kushtet e konflikt interesave", apo në fund?

Z. M. Çakaj: Si teknikë legjislativë më shkon më shumë pas pikës "dh", pra në rastin kur kemi rastet e mosqenies...

Znj. I. Nano: Të mos ndodhet në kushtet e konfliktit të interesave.

Z. M. Çakaj: Në kushtet e konfliktit interesit, kështu që pas pikës "dh", shtohet pika "e" dhe më pas riformulimi të vijojë më poshtë. Pra, të marrë shkronjë tjetër, të ketë njohuri dhe pika e fundit, shkronja e fundit, të jetë i gatshëm të marrë shkronjë tjetër, faleminderit!

Znj. I. Nano: Në rregull! Propozim tjetër, zonja Vukaj?

Znj. H. Vukaj: Nuk kam një propozim, por një saktësim meqenëse bëra ndërhyrjen pak më parë tek neni 2 dhe saktësova se operatori teknik, nuk duhet të jetë në marrëdhënie pune me kandidatin dhe thashë, as me bashkëshortin, bashkëshorten, birin, bijën, prindërit apo vjehri, vjehrra. Meqenëse propozimi i zotit Çakaj e përfshin dhe meqenëse ka sens gjeneralist dhe gjithëpërfshirës, kjo pikë e shtuar, i qëndroj që të ezaurohet me këtë rast.

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.31.01.2022*

Znj. I. Nano: Me propozimin e zotit Çakaj?

Znj. H. Vukaj: Po!

Znj. I. Nano: Kolegë, zoti Kaziaj, propozim konkret për nenin 3?

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Unë kisha vetëm një kërkesë për sa i përket administratës dhe Sekretarit të Përgjithshëm, lidhur me gërmën “ç” të nenit 3, pika 2, ndërkohë që nga teksti i vjetër flitet për administratë zgjedhore, në tekstin e ri është “komisione zgjedhore”. Ndërkohë që në Kodin Zgjedhor neni 2 të tij, nuk gjej dot, se çfarë nënkupton ligjvënësi me përkufizimet, me këto dy përkufizime. Në qoftë se mundet pak Sekretari i Përgjithshëm të na shpjegojë pak faktin e ndryshimeve...

Znj. I. Nano: Germën “ç”.

Z. Y. Merkaj: Kemi pasur parasysh komisionet zgjedhore, komisioni i qendrës së votimit dhe komisioni i zonës së administrimit zgjedhor. Se grupet e numërimit janë shënuar mbrapa.

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Ndërkohë që në tekstin e vjetër të nenit nr.7, 2021 administrata zgjedhore ishte më gjithëpërfshirëse, të themi?

Z. Y. Merkaj: Po, ka qenë dhe KQZ-ja.

Znj. I. Nano: Në nenin 3, të vendimit të mëhershëm?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Po, në vendimin 3, të vendimit të mëhershëm!

Znj. I. Nano: U sqaruar zoti Kaziaj? Në rregull! Atëherë kalojmë në votimin e propozimit të zotit Çakaj. Pas shkronjës “dh”, të pikës 2, të nenit 3, shtohet shkronja “e” me këtë përmbajtje “të mos ndodhet në kushtet e konfliktit të interesave”

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S’ka

Me 5 vota pro miratohet!

Duke qenë që nuk ka propozim tjetër për nenin 3, do të duhet të kalojmë në votimin në tërësi të nenit 3 pas miratimit të propozimit të zotit Çakaj.

Kush është dakord me nenin 3?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S’ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Neni 4. Është përparësia në përzgjedhje.

Më lejoni ta lexoj, nuk është i gjatë si nen, pikërisht sepse edhe nëpërmjet kësaj mbledhjeje do të doja ta shfrytëzoja për të bërë një fushatë ndërgjegjësimi për të aplikuar për operatorë për përdorimin e pajisjeve të identifikimit elektronik të votuesve. Të gjitha kushtet dhe kriteret u miratuan më herët. Ndërkohë rradha e përzgjedhjes, pra kush ka përparësi në përzgjedhje është kjo:

- a. Të diplomuar me master IT
- b. Të diplomuar bachelor IT
- c. Studentë master IT
- d. Studentë bachelor IT

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.31.01.2022*

Le të themi, i jepet përparësi studentëve, apo të diplomuarve në këtë degë specifike që kërkon njohuri lidhur me përdorimin e këtyre lloj pajisjeve. Pas tyre kërkohej të diplomuar master jo IT, të diplomuar bachelor jo IT, studentë master jo IT, studentë bachelor jo IT dhe kategoria e fundit, çdo shtetas me arsim të mesëm që përmbush kushtet dhe kriteret e miratuara më herët mundet të aplikojë. Kolegë, kemi diçka lidhur me nenin 4, përparësia në përzgjedhje? Nëse jo, kalojmë në votimin e nenit 4.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Vijmë tek neni 5. Futemi në disa procedura, paraqitja e kërkesës. Pas miratimit të këtij vendimi është Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, i cili do të shpallë publikisht njoftimin, thirrjen për shprehje interesi dhe më tej do të aplikohet në faqen e KQZ-së për operatorët teknikë. Kemi diçka lidhur me nenin 5? Nëse jo, kalojmë në votimin e nenit 5.

Kush është dakord me nenin 5, paraqitja e kërkesës?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Neni 6. Procedurat e shqyrtimit të kërkesave.

Edhe kjo sikundër u theksua në relacionin e prezantuar nga Sekretari i Përgjithshëm, ky proces drejtohet, mbikëqyret dhe monitorohet nga Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, si zyrtar i caktuar nga Kuvendi, pikërisht për implementimin e projekteve të teknologjisë në zgjedhje. Ndonjë propozim për shtesë apo ndryshim? Nëse jo, kalojmë në votimin e nenit 6.

Kush është dakord, kolegë?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Neni 7. Caktimi i operatorëve teknikë.

Janë pikërisht Komisioneri dhe Nënkomisioneri që caktojnë operatorët teknikë, kështu është parashikuar në këtë nen. Madje edhe një listë rezervë e personave të përzgjedhur që mund shërbejë për ta zëvendësuar operatorin teknik, i cili nuk paraqitet në qendrën e votimit për të ofruar shërbimin. Kemi ndonjë koment shtesë/ndryshim në nenin 7. Jo! Kalojmë në votimin e nenit 7.

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Neni 8. Përgjegjësitë e operatorëve teknikë.

Ndonjë propozim, koment, pyetje? Nëse jo, kalojmë në votimin e nenit 8.

Përgjegjësitë e operatorëve teknikë.

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Neni 9. Ofrimi i shërbimit, i cili parashikon që ofrimi i shërbimit të bëhet në përputhje me një kontratë që do të nënshkruhet mes KQZ-së dhe operatorit. Gjithashtu parashikohet mundësia e shpërblimit, për këtë shërbim të ofruar, por sigurisht ky shpërblim nuk do të jetë pjesë e aktit tonë rregullator, por do të jetë pjesë e vendimit të Komisionerit dhe Nënkomisioneres Shtetërore të Zgjedhjeve. Ndonjë propozim apo koment lidhur me nenin 9? Nëse jo, kalojmë në votimin e nenit 9.

Kush është dakord me nenin 9?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Neni 10 parashikon votimin e operatorëve teknikë duke pasur parasysh faktin që janë zgjedhës dhe mundet të jenë edhe madje në këto zgjedhje që po presim të pjeshmet, mund të jenë zgjedhës në një qendër votimi konkrete. Është parashikuar mënyra dhe vendi ku votojnë operatorët teknikë. Pra, pikërisht aty ku ofrohet shërbimi i tyre, në qendrën konkrete të votimit. Nga administrata kemi ndonjë diskutim? Nga kolegët? Zoti Kaziaj?

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Po mundohem ta lexoj pak me tekstin e vendimit të vjetër, duke qenë se koha në dispozicion ishte kjo që ishte.

Znj. I. Nano: Në dallim nga akti i vjetër, sigurisht që në këtë rast janë shtuar zgjedhjet e pjeshme, ku operatorët teknikë votojnë pranë qendrës së votimit ku janë caktuar, nëse janë pjesë e listës përkatëse të zgjedhësve. Duke qenë që më herët kemi miratuar faktin që mund të jenë me vendbanim në qarkun konkret, pra, në rastin tonë, në rastin e bashkisë ku zhvillohen zgjedhjet...

Z. Y. Merkaaj: Për zonë zgjedhore është qarku, në zgjedhjet për Kuvend dhe në zgjedhjet vendore është bashkia zonë zgjedhore, prandaj e kemi përcaktuar.

Z. M. Çakaj: Më fal! Këtu parashikohet që operatorët teknikë votojnë pranë qendrës së votimit ku janë caktuar, nëse janë pjesë e listës përkatëse të zgjedhësve, pra nënkupton qendrën e votimit, apo zonën zgjedhore?

Z. Y. Merkaaj: Zonën zgjedhore, bashkinë. Në qoftë se janë zgjedhës të bashkisë...

Z. M. Çakaj: Atëherë duhet ta shtojmë këtu. Sepse e formuluar kështu, ngjan sikur operatorët duhet të jenë pjesë e asaj qendre votimi.

Znj. I. Nano: Janë dy fjali të ndryshme. Njëra është e përgjithshme, tjetra është për zgjedhjet e pjesshme.

Z. M. Çakaj: Po, pra, operatorët teknikë votojnë pranë qendrës së votimit ku janë caktuar për të ofruar shërbimin. Këtu jemi dakord. Për zgjedhjet e pjesshme, operatorët teknikë votojnë pranë qendrës votimit ku janë caktuar nëse janë pjesë e listës përkatëse të zgjedhësve.

Z. Y. Merkaç: Qëllimi ynë ka qenë që ai të jetë pjesëtar i zonës zgjedhore të bashkisë.

Z. M. Çakaj: Dakord!

Z. Y. Merkaç: Ndoshta e kemi shprehur gabim, mund ta theksojmë.

Z. M. Çakaj: E ka kriter këtë, por mos ndoshta një riformulim na e qartëson?

Z. Y. Merkaç: Mund ta bëjmë, në zonën zgjedhore.

Z. M. Çakaj: Në fjalinë e dytë, një riformulim na e qartëson, që bëhet fjalë për listën përkatëse të zgjedhjeve dhe bëhet fjalë për atë zonë zgjedhore.

Znj. I. Nano: Për listën e zgjedhësve të zonës përkatëse zgjedhore.

Z. M. Çakaj: Po, dakord!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Mundem kryetare?

Znj. I. Nano: Po, zoti Kaziaj!

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Kurse unë këtë fjalinë e dytë, te neni 10 e kuptoj që, po jua lexoj për të më ndjekur pak. “Për zgjedhjet e pjeshme operatori i teknikës”, teknik duhet të ishte “votojnë pranë qendrës së votimit ku janë caktuar, nëse janë pjesë e listës përkatëse të zgjedhësve” Po nëse nuk janë pjesë e listës, do të rekrutohen?

Znj. I. Nano: Do të thotë nuk votojnë për atë bashki.

Z. M. Çakaj: Thjesht nuk votojnë dot në atë qendër votimi. Madje, të nderuar kolegë, nisur nga problematikat që kishim në procesin e rekrutimit të operatorëve, unë propozoj që ta hapim pak këtë dhe të themi qartë, të shtojmë konceptin e qarkut.

Znj. I. Nano: Në nenin 3, zoti Çakaj, e kemi tek neni 3. Në nenin 3, pika 3 themi “operatori teknik duhet të jetë me vendbanim në territorin e qarkut ku ndodhet qendra e votimit”.

Z. M. Çakaj: Po, dakord, më fal, por ky është kriteri për t’u zgjedhur. Po marrim rastin për të votuar.

Znj. I. Nano: Që do të thotë, nuk do të vijë nga një qark tjetër. Pra, brenda qarkut nuk janë, të paktën në zgjedhjet e pjeshme, jo domosdoshmërisht janë të gjitha bashkitë pjesë e qarkut në të cilin do të votojnë.

Z. M. Çakaj: Dakord! Po për bashkitë që kanë më shumë se një ZAZ?

Znj. I. Nano: Po, pra! Nëse është në listën e zgjedhësve.

Z. M. Çakaj: Unë propozoj që ta hapim...i ke me ZAZ...

Z. Y. Merkaç: Atëherë, zonë zgjedhore është bashkia, pavarësisht se ka 4 KZAZ, Durrësi. Është zonë zgjedhore gjithë Bashkia Durrës.

Diskutime në panel.

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Më fal, me i dhënë të drejtën për të punuar si operator dhe t'i heqësh të drejtën e votimit një personi, mua më duket pak...

Znj. I. Nano: Ndjesë, nuk i hiqet, të lutem është kuptuar gabim! Atëherë po marrim një rast.

Z. M. Çakaj: Atëherë ta saktësojmë!


Znj. I. Nano: Të lutem a mund ta marr një shembull?

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Ai duhet të jetë nga ora 7 deri në orën ...

Znj. I. Nano: Të lutem zoti Kaziaj, të lutem...

Z.A.Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Ja ta mbaroj fjalën!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



Znj. I. Nano: Të lutem, jo! Sapo thatë diçka që nuk qëndron, t'i hiqet e drejta e votimit, askujt nuk po i hiqet e drejta e votimit, ndaj po të sqaroj. Të lutem, po të sqaroj çfarë kuptimi ka dispozita!

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Më lini të mbaroj unë fjalën dhe...!

Znj. I. Nano: Të lutem! Jo! Tërhiquni nga pjesa që po i hiqet e drejta e votimit.

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Si më lutesh, unë nuk e kisha mbaruar fjalën!

Znj. I. Nano: Atëherë rasti i zgjedhjeve të përgjithshme, ndryshon koncepti i zonës zgjedhore. Rasti i zgjedhjeve vendore, edhe këto të pjesshmet janë vendore, ndryshon koncepti i zonën zgjedhore. Po marr një shembull për të kuptuar që nuk i mohohet askujt e drejta e votimit. Në nenin 3, në pikën 3 sapo miratuar "operatori teknik duhet të jetë me vendbanim në territorin e qarkut ku ndodhet qendra e votimit, ku ai do të caktohet nga KQZ-ja". Marrim rastin e Lushnjes. A mundet sipas kësaj që ne kemi votuar, që një votues i bashkisë së Fierit të përzgjidhet operator në zgjedhje, i qarkut të Fierit, por po them në bashkinë e Fierit, të përzgjidhet operator në një qendër votimi në këto zgjedhje?

Z. M. Çakaj: Po! Mundet!

Znj. I. Nano: Atëherë, a voton ky?

Z. M. Çakaj: Sigurisht që jo!

Znj. I. Nano: Po këtë jemi duke thënë!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



Z. M. Çakaj: Po ku është e shprehur kjo, të lutem e nderuar?

Znj. I. Nano: Voton pranë qendrës ku janë caktuar, nëse janë pjesë e listës përkatëse të zgjedhësve.

Z. M. Çakaj: Po! Ky rasti është i qartë, shumë i qartë. Por po marrim një rast tjetër, ta vazhdojmë si shembull?

Znj. I. Nano: Patjetër!

Z. M. Çakaj: Atëherë po marrim një rast tjetër. Kemi Bashkinë Durrës. Është shtetas, është zgjedhës në një njësi administrative të Bashkisë Durrës, por... prandaj e doja të qartë këtë konceptin e KZAZ-ve. Nëse të 4 KZAZ-të konsiderohen një zonë zgjedhore, atëherë është e qartë. Atëherë riformulimi, nëse është pjesë e listës përkatëse të zgjedhësve të asaj bashkie, të zonës zgjedhore, të bashkisë, çfarë rëndësie ka? Besoj në këtë kontekst e kishte dhe zoti Kaziaj.

Znj. I. Nano: Zonë zgjedhore, por vetëm fjala përkatëse.

Z. M. Çakaj: Po, por nuk është fjala zonë zgjedhore

Znj. I. Nano: Të zonës përkatëse zgjedhore, mund të vihet.

Z. M. Çakaj: Atëherë biem dakord që ka nevojë për një saktësim?

Znj. I .Nano: Pra, ose listës përkatëse të zgjedhësve në zonën zgjedhore ose listës...

Z. M. Çakaj: Të bashkisë ku votohet, është më e qartë.

Z. D. Çaka: Atëherë, në qoftë se do t'i referohemi edhe konceptit që kemi zonë zgjedhore dhe tek përkufizimet, Kodi e ka përcaktuar që zonë zgjedhore për zgjedhjet e Kuvendit është qarku. Ndërsa për zgjedhjet e pushtetit vendor është bashkia. Ateherë vendosim zonë zgjedhore.

Z. M. Çakaj: Dakord! Është më e qartë për operatorët. Unë propozoj që ne hartimin e këtij akti ta bëjnë sa më të qartë, për ata atje, operatorët. Nuk do të hapin kodin ata ta lexojnë në momentin që të identifikojnë të drejtën e tyre. Kanë apo s'kanë të drejtë të votojnë! Ata do shikojnë aktin tonë.

Znj. I. Nano: E ke dhe tek manuali i KQV-ve atë patjetër, se kush voton në atë qendër. Pra, propozimi është, në listën e zgjedhësve të zonës përkatëse zgjedhore?

Z. M. Çakaj: Ose në listën e zgjedhësve që janë pjesë e listës përkatëse të zgjedhësve të asaj bashkie, ose të asaj zone zgjedhore. Ky togfjalësh të shtohet në fund.

Znj. I. Nano: Dhe bashki dhe zonë zgjedhore, se është e njëjta gjë?

Z. M. Çakaj: Ose zonë zgjedhore, ose të asaj bashkie. Ky togfjalësh të shtohet, ose njëra ose tjetra. Si ta gjykojmë këtu.

Znj. I. Nano: Jo, meqë po bëni propozimin..., ose le t'i drejtohemi dhe administratës. Propozimi i zotit Çakaj besoj është i qartë, por në formulim mendoni të zonës përkatëse zgjedhore apo të bashkisë përkatëse?

Z. Y. Merkaj: Meqenëse kjo do të jetë për operatorët është më mirë bashkia sepse kuptohet më thjeshtë. Zonën zgjedhore e kuptojmë ne të tjerët, por ndoshta operatorët nuk e kuptojnë.

Znj. I. Nano: Listës së zgjedhëse të bashkisë përkatëse? Në rregull! U formulua propozimi. Propozim tjetër për nenin 10? Zoti Kaziaj, keni propozim?

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Jo, faleminderit që më dhatë fjalën dhe nuk më mbyllët mikrofonin kësaj here. Falenderoj zotin Çakaj që ju bëri të reflektonit ju...

Znj. I. Nano: Zoti Kaziaj! Në këtë mbledhje unë duhet t'ju tërheq përsëri vëmendjen. Në këtë mbledhje jeni për të bërë propozime konkrete, për të bërë pyetje dhe jo për të bërë komente për anëtarët e Komisionit Rregullator. Atëherë unë po ju pyes keni propozim konkret për nenin 10 apo jo?

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Ju po më ndërprisni fjalën nuk po më pyesni. Unë jam përfaqësuesi i Lëvizjes Socialiste për Integrim dhe vij këtu për të mbrojtur interesat e partisë time...

Znj. I. Nano: Absolutisht! Të gjithë përfaqësuesit e partive...

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Atëherë, ju duhet të më jepni fjalën dhe mua metoda e inkuizitore ju nuk më bëni dot!

Znj. I. Nano: Ju jap fjalën dhe në bazë të rregullores tonë, ju keni të drejtën të bëni propozim...

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Po, mua do më lini të kem fjalën time. Jam i vetmi përfaqësues i partisë politike, i partive politike në këtë komision...

Znj. I. Nano: Fjala juaj lidhet, në këtë fazë të shqyrtimit të aktit keni të drejtën për të bërë propozime për nene konkrete, shtesa, ndryshime.

Atëherë kolegë, votojmë propozimin e zotit Çakaj në nenin 10. Fjalja e dytë të riformulohet "për zgjedhjet e pjeshme operatorët teknikë votojnë pranë qendrës së votimit ku janë caktuar, nëse janë pjesë e listës së zgjedhësve të bashkisë përkatëse".

Kush është dakord ju lutem?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Neni 11. Hyrja në fuqi. Pika e parë. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Pika 2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës së Apelit Administrativ Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Kalojmë në votimin në tërësi të projektaktit. Pasi e kemi votuar atë në parim dhe nen për nen.

*Zbardhi materialin audio
Menita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.31.01.2022*

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Duke qenë që nuk kemi akt tjetër ose çështje jashtë rendit të ditës për të diskutuar. Duke ju falenderuar të gjithëve, e deklaroj mbledhjen të mbyllur, faleminderit!

Vendimi nr. 11

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

